

ASSESSMENT METHODS AND INSTRUMENTS DURING DISTANCE LEARNING

Hysen Balaj

“Dëshmorët e Kombit” – Deçan, Kosovo, hysen.balaj@hotmail.com

Abstract: Distance Learning in Kosovo in terms of COVID-19 pandemic, led to the idea of organizing distance learning. Given the insufficient time and lack of experience, it must be admitted that this form of learning is faced with unknowns, which should be addressed in a timely manner and adapting context.

The purpose of this research paper is focused, to analyze the existing situation and present approaches, methods and assessment tools in distance learning. How much do teachers adhere to student assessment according to competency-based curriculum requirements. At the same time, this paper has two other purposes: to identify creative ways of evaluating students' work forms, and to present an overview of the different ways of assessing and their impact on student motivation, during the learning process in distance.

In this research, the method with quantitative approach will be applied due to the circumstances created during the COVID-19 pandemic. The quantitative approach will be realized through the questionnaire with teachers and students, which will be developed through the google form platform. To research and study this problem in the most argumentative way, we will use the following methods: The method of theoretical, comparative and statistical analysis. The research will include a lower secondary school (SHMU) in the municipality of Deçan, with 6-9 level teachers and students.

In conclusion, this study aims to help teachers understand correctly the changes in student assessment and to develop skills in implementing distance assessment, as a new and challenging form of time, but necessary for the realization of curriculum-based requirements. . The results obtained from the research will be reflected in ways specified according to the group of questions and according to the group of participants involved in the research.

Keywords: assessment, methods, curriculum, distance learning.

METODAT DHE INSTRUMENTET E VLERËSIMIT NË DISTANCË

Hysen Balaj

“Dëshmorët e Kombit” – Deçan, Kosovo, hysen.balaj@hotmail.com

Abstrakt: Mësimi në distancë në Kosovë në kushtet e pandemisë COVID-19, solli deri te ideja e organizimit të mësimit në distancë. Duke pasur parasysh kohën jo të mjaftueshme dhe mungesën e përvojës, duhet pranuar se kjo formë e mësimit ballafaqohet me të panjohura, të cilat duhet të adresohen me kohë dhe duke ju përshtatur kontekstit. Qëllimi i këtij punimi shkencor është i fokusuar, të analizojë gjendjen ekzistuese dhe të paraqes qasjet, metodat dhe instrumentet e vlerësimit gjatë mësimit në distancë. Sa i përmbahen mësimdhënësit vlerësimit të nxënësve sipas kërkesave të kurrikulës bazuar në kompetenca. Njëkohësisht, ky punim ka edhe dy qëllime të tjera: identifikimit të mënyrave kreative të formave për vlerësimin e punës së nxënësve, si dhe të paraqet një pasqyrë të mënyrave të ndryshme të vlerësimit dhe ndikimet e tyre në motivimin e nxënësve, gjatë procesit të mësimit në distancë.

Në këtë hulumtim do të aplikohet metoda me qasje sasiore për arsye të rrethanave të krijuara gjatë kohës së pandemisë COVID-19. Qasja sasiore do të realizohet përmes pyetësorit me mësimdhënës dhe nxënës, i cili do të zhvillohet përmes platformës google form. Për të hulumtuar dhe studiuar këtë problem në mënyrë sa më argumentuese, do të përdorim metodat : Metoda e analizës teorike, krahasuese dhe statistikore. Në hulumtim do të përfshihet një shkollë të mesme e ulët (SHMU) në komunën e Deçanit, me mësimdhënës dhe nxënës të nivelit 6-9.

Si përfundim, ky studim synon të ndihmojë mësimdhënësit për të kuptuar drejtë ndryshimet në vlerësimin e nxënësve dhe për të zhvilluar shkathtësitë në zbatimin e vlerësimit në distancë, si një formë e re dhe sfiduese për kohën, por e nevojshme për realizimin e kërkesave bazuar në kurrikul. Rezultatet e fituara nga hulumtimi, do të pasqyrohen në mënyra të specifikuar sipas grupit të pyetjeve dhe sipas grupit të pjesëmarrësve, të përfshirë në hulumtim.

Fjalët kyçe: vlerësimi, metodat, kurrikul, mësimi në distancë.

1. HYRJJE

Pandemia COVID-19 konsiderohet një sfidë jo vetëm për vendin tonë, nga fakti se shtrirja e saj është me përmasa globale, e cila ka ndikuar në çdo aspekt të shoqërisë, duke mos kursyer edhe arsimin. Të gjithë ne jemi sfiduar me përpjekjen për të bashkërenditur dhe bashkëpunuar me institucionet arsimore, organizatat të cilat merren me fushën

e arsimit, shtëpitë botuese etj. për zbatimin e mësimit në distancë dhe vlerësimin e njohurive të nxënësve (MASR, UVND, Tiranë 2020:7).

Është e rëndësishme që të mos mbështetemi vetëm në praktikën dhe strategjitë e vlerësimit përmbledhës të provuar gjatë më tani, por gjatë kësaj kohe ne duhet të reflektojmë në ato praktika dhe strategji duke përdorur qasje ndryshe lidhur me vlerësimin e njohurive të nxënësve në distancë (Andrea Mmiller, Aprill 2020, <https://www.edutopia.org/article/summative-assessment-distance-learning>). Prandaj edhe duhet pranuar se mësimi në distancë në Kosovë ballafaqohet me të panjohura, të cilat duhet të adresohen me kohë dhe duke ju përshtatur kontekstit (MASHT, UVND, Prishtinë 2020:7).

2. QËLLIMI I HULUMTIMIT

Qëllimi i realizimit të hulumtimit është sigurimi i informacioneve të mjaftueshme lidhur me metodat dhe instrumentet e vlerësimit gjatë mësimit në distancë. Sa i përmbahen mësimeve të vlerësimit të nxënësve sipas kërkesave të kurrikulës bazuar në kompetenca. Poashtu, objekt hulumtimi do të jenë: mënyrat kreative, tërheqëse dhe inspiruese të formave për vlerësimin e punës së nxënësve, si dhe ndikimin e vlerësimit në motivimin e nxënësve, gjatë procesit të mësimit në distancë.

Nisur nga autori, Pole dhe Lampard rreth hulumtimit mund të mbështetemi tek mendimi i tyre ku thonë se “Hulumtimi nuk është diçka që ndodh vetvetiu. Ai duhet të ketë gjithmonë një qëllim... hulumtimi duhet të na japë njohuri që janë të shëndosha, të mbrojtshme dhe të dobishme” (Matthews & Ross 2010:9)

3. METODOLOGJIA E HULUMTIMIT

Meqenëse vlerësimi në distancë u krijua në rrethana të jashtëzakonshme, besojmë se ende nuk kemi një hulumtim të tillë, andaj në këtë hulumtim kemi aplikuar metoda me qasje sasiore për arsye të rrethanave të krijuara gjatë kohës së pandemisë COVID-19. Qasja sasiore është realizuar përmes pyetësorit me mësimeve të nxënësve, i cili është zhvilluar përmes platformës google form. Për të hulumtuar dhe studiuar këtë problem në mënyrë sa më argumentuese, kemi përdorur këto metoda: Metoda e analizës teorike, krahasuese dhe statistikore.

Në hulumtim do të përfshihet një shkollë e mesme e ulët (SHMU) në komunën e Deçanit, me mësimeve të nxënësve të nivelit 6-9, ku janë përfshirë 25 mësimeve të nxënësve dhe 50 nxënës.

Pas studimit të anës teorike kemi përdorur analizën diskriptive- përshkruese, ku kemi bërë përshkrimin e të dhënave të nxjerra nga hulumtimi. Po ashtu, kemi përdorur metodën e analizës komparative- krahasuese. Përmes kësaj metode bëhet krahasimi i mendimeve të mësimeve të nxënësve lidhur me vlerësimin e njohurive gjatë procesit të mësimit në distancë. Ndërsa, përmes analizës statistikore kemi bërë përpunimin e rezultateve të nxjerra nga hulumtimi për interpretimin tyre.


4. REZULTATET E HULUMTIMIT

Gjetjet e studimit realizohen përmes analizës së pyetësorëve, e cila ka për qëllim të kuptojë metodat dhe instrumentet e vlerësimit gjatë mësimit në distancë duke u mbështetur sipas kërkesave të kurrikulës bazuar në kompetenca.


Më poshtë do t'i paraqesim rezultatet e hulumtimit të nxjerra nga anketimi i mësimeve të nxënësve përmes platformës google form.

a. Rezultatet e hulumtimit nga pyetësorët me mësimeve të nxënësve


1. Sa kanë qenë sfiduese metodat e përdorura për vlerësimin e njohurive të nxënësve në distancë?




2. A mendoni se keni marr informacionet e duhura dhe të nevojshme nga institucionet përkatëse (MASHT, DKA, Drejtori shkollës etj.) për vlerësimin e njohurive të nxënësve në distancë.




3. Cilat platforma/aplikacione të mësimi në distance i keni përdorur për vlerësimin e njohurive të nxënësve në distance ? (sipas nevojës mund të zgjidhni më shumë se dy opsione)




4. A mendoni se mund të praktikohet vlerësimi i njohurive të nxënësve në distancë edhe në formën e mësimi të rregullt



5. Sa ju keni përmbytur dhe i keni realizuar parimet e vlerësimi të njohurive të nxënësve në distancë?



6. Cilat nga metodat për vlerësimin e njohurive të nxënësve që i keni përdorur gjatë mësimi në distancë, kanë qenë më efektive në aplikim?




Duke u mbështetur në të dhënat e marra nga mësimdhënësit përmes pyetësorit dhe rezultate të tabelës 1, **sa keni pasur vështirësi me metodat e përdorura nga mësimdhënësit për vlerësimin e njohurive gjatë mësimi në distancë**, kemi këto të dhëna : 24% kanë deklaruar shumë, 48% deri diku, 20% pak dhe aspak 8%. Në pyetjen, **a mendoni se keni marr informacionet e duhura dhe të nevojshme nga institucionet përkatëse (MASHT, DKA, Drejtori shkollës etj.) për vlerësimin e njohurive të nxënësve në distancë**, kemi këto rezultate: 34.7 % kanë deklaruar shumë, 38.8 % deri diku, 18.4 % pak dhe aspak 8.2 %. Ndërsa, lidhur me **platformat/aplikacionet të mësimi në distancë i kanë përdorur për vlerësimin e njohurive të nxënësve në distancë**, kemi këto të dhëna: 23 (92 %) kanë deklaruar zoom, 6 (24 %) skype, 20 (80 %) viber, 1 (4 %) teams dhe goole classroom 13 (52%). Në pyetjen, **a mendoni se mund të praktikohet vlerësimi i njohurive të nxënësve në distancë edhe në formën e mësimi të rregullt**, rezultatet tregojnë se, 12 % kanë deklaruar shumë, 64 % deri diku, 20 % pak dhe aspak 4 %. Lidhur me pyetjen e pestë, **sa ju keni përmbytur dhe i keni realizuar parimet e vlerësimi të njohurive të nxënësve në distancë**, kemi këto të dhëna: *Mirëqenia e nxënësve*: 17 mësimdhënës janë deklaruar shumë, ndërsa 8 deri diku; *Vlefshmëria dhe besueshmëria*: 11 mësimdhënës shumë, deri diku 13 dhe 1 pak; *Transparenca*: 16 mësimdhënës kanë deklaruar shumë, deri diku 9 mësimdhënës; *Etika*: 21 mësimdhënës janë përgjigjur shumë dhe 4 deri diku; *Gjithëpërfshirja*: shumë 10 mësimdhënës, deri diku 10 mësimdhënës dhe pak 5 mësimdhënës. Lidhur me pyetjen e 6, **cilat nga metodat për vlerësimin e njohurive të nxënësve që i keni përdorur gjatë mësimi në distancë, kanë qenë më efektive në aplikim**, kemi këto rezultate: *Vëzhgimi dhe vlerësimi me gojë gjatë mësimi në distancë*: 15 mësimdhënës kanë deklaruar Shumë, 8 Deri diku, 2 Pak; *Vlerësimi i diskutimeve të situatave konkrete nga jeta reale*: 8 Shumë, 12 Deri diku, 5 Pak; *Paraqitja e detyrave dhe e punimeve gjatë mësimi në*


distancë: 15 Shumë, 9 Deri diku, 1 Pak; *Vlerësimi nëpërmjet një projekti dhe detyre krijuese gjatë mësimit në distancë*: 13 Shumë, 7 Deri diku, 5 Pak; *Vlerësimi me shkrim gjatë mësimit në distancë*: 6 Shumë, 13 Deri diku, 5 Pak, 1 Aspak; *Vetëvlerësimi dhe vlerësimi ndërmjet nxënësve gjatë mësimit në distancë*: 8 Shumë, 6 Deri diku, 8 Pak, 3 Aspak; *Vlerësimi i angazhimit dhe i pjesëmarrjes gjatë mësimit në distancë*: 15 Shumë, 9 Deri diku, 1 Pak.

b. Rezultatet e hulumtimit nga pyetësorët me nxënës


1. Sa keni pasur vështirësi me metodat e përdorura nga mësimitdhënësit për vlerësimin e njohurive gjatë mësimit në distancë?




2. Sa jeni informuar nga mësimitdhënësit e lëndëve përkatëse lidhur për metodat e vlerësimin të njohurive ?




3. Sa kanë qenë mësimitdhënësit mbështetës, të durueshëm, inkurajues, pozitivë dhe të vëmendshëm gjatë procesit të vlerësimin ?




4. A mendoni se ky lloj vlerësimi ka qenë i kujdesshëm, i vlefshëm dhe i besueshëm?




5. Sa mësimitdhënësit kanë qenë qartë dhe të paanshëm- transparent lidhur me vlerësimin e njohurive ?



6. Metodrat dhe teknikat e përdorura nga mësimitdhënësit gjatë procesit të vlerësimin, a kanë arritur të sigurojnë pritshmërit e juaja?



7. A mendoni se mund të praktikohet vlerësimi i njohurive tuaja në distancë edhe në formën e mësimit të rregullt ?



Nga të dhënat e marra përmes pyetësorit me nxënës dhe rezultateve të tabelës 1, **Sa keni pasur vështirësi me metodat e përdorura nga mësimitdhënësit për vlerësimin e njohurive gjatë mësimit në distancë?**, kemi këto të dhëna : 4.1% kanë deklaruar shumë, 36.7% deri diku, 30.6% pak dhe aspak 28.6%. Në pyetjen, **Sa jeni informuar nga mësimitdhënësit e lëndëve përkatëse lidhur për metodat e vlerësimin të njohurive ?**, kemi këto rezultate: 34.7 % kanë deklaruar shumë, 38.8 % deri diku, 18.4 % pak dhe aspak 8.2 %. Ndërsa, **Sa kanë qenë**

mësimdhënësit mbështetës, të durueshëm, inkurajues, pozitivë dhe të vëmendshëm gjatë procesit të vlerësimit ?, kemi këto të dhëna: 61.2% shumë, 20.4% deri diku, 10.2% pak dhe 8.2% aspak.

Në pyetjen, **a mendoni se ky lloj vlerësimi ka qenë i kujdesshëm, i vlefshëm dhe i besueshëm?, rezultatet tregojnë se**, 38.8 % kanë deklaruar shumë, 40.8 % deri diku, 6.1 % pak dhe aspak 14.3 %. Lidhur me pyetjen e pestë, **sa mësimdhënësit kanë qenë qartë dhe të paanshëm- transparent lidhur me vlerësimin e njohurive ?**, kemi këto të dhëna: 38.8% janë deklaruar shumë, 36.7% deri diku, 18.4% pak dhe aspak 6.1%. Të dhënat e nxjerra nga pyetja e gjashtë lidhur me **, metodat dhe teknikat e përdorura nga mësimdhënësit gjatë procesit të vlerësimit, a kanë arritur të sigurojnë pritshmërinë e juaja?**, kemi këto rezultate: shumë 30.6%, deri diku 44.9%, pak 10.2% dhe aspak 14.3%. **A mendoni se mund të praktikohet vlerësimi i njohurive tuaja në distancë edhe në formën e mësimin të rregullt ?**, të dhënat e pyetësorit na japin këto rezultate: shumë 28.6%, deri diku 30.6%, pak 18.4% dhe aspak 22.4%.

5. PËRFUNDIMET

Si konkluzion, nga analiza e të dhënave nga tabela , lidhur me vështirësitë me metodat e përdorura nga mësimdhënësit për vlerësimin e njohurive gjatë mësimin në distancë, rezultoni se deri diku mësimdhënësit kanë pasur vështirësi në përdorimin e metodave për vlerësimin e nxënësve. Nëse i referohemi rezultateve nga anketimi i nxënësve lidhur me të njëjtën çështje, rezultoni se nxënësit kanë pasur më pak vështirësi në krahasim me mësimdhënësit. Ndërsa, sa i përket informacioneve që i kanë mësimdhënësit nga institucionet përkatëse (MASHT, DKA, Drejtori shkollës etj.) për vlerësimin e njohurive të nxënësve në distancë, nga të dhënat e anketimit rezultoni se deri diku mësimdhënësit kanë marr informacione të duhura dhe të nevojshme. Poashtu, nga rezultatet e anketimit me nxënës sa jeni informuar nga mësimdhënësit e lëndëve përkatëse lidhur për metodat e vlerësimit të njohurive kemi përqindje të përafërt, kjo tregon se informacionet deri diku i kanë përmbushur kërkesat, por jo edhe mjaftueshëm. Sigurisht, kjo ka ndodhur si rezultat i kohës së kufizuar dhe mospërvojës. Sa i përket platformës/aplikacionit që kanë përdorur mësimdhënësit në vlerësimin e njohurive të nxënësve, kryesisht dominon platforma zoom.

Duke u mbështetur në të dhënat e marra nga mësimdhënësit dhe nxënësit përmes pyetësorit, dhe rezultateve të tabelës 4 dhe 7 lidhur me praktikimin e vlerësimit të njohurive të nxënësve në distancë edhe në formën e mësimin të rregullt, rezultoni se nxënësit shprehin gatishmëri më të lartë se sa mësimdhënësit në zbatimin e vlerësimit të njohurive përmes aplikimit të kësaj platforme në të ardhmen.

Lidhur me respektimin e parimeve të vlerësimit të njohurive të nxënësve në distancë, rezultoni se mësimdhënësit u janë përmbajtur parimeve bazë, kryesisht dominon etika dhe mirëqenia e nxënësve. Mësimdhënësit u janë përmbajtur misionit, detyrave dhe normave etike profesionale, poashtu duke pasur përsysh gjendje nga pandemia COVID-19, janë kujdesur për mirëqenien e nxënësve që të mos sjellin frikë, ankth dhe pasiguri. Duke iu referuar tabelës 3, nga anketimi i nxënësve, rezultoni se edhe nxënësit janë shprehur të kënaqur me mësimdhënësit, të cilët kanë qenë mbështetës, të durueshëm, inkurajues, pozitivë dhe të vëmendshëm gjatë procesit të vlerësimit.

Nga analiza e të dhënave nga pyetësori me mësimdhënësit në grafikun 5 dhe figura 4 tek nxënësit, lidhur vlefshmërinë dhe besueshmërinë e vlerësimit të njohurive të nxënësve në distancë, rezultoni se janë përdorur instrumente, kritere të duhura dhe të qarta që vlerësimi të jetë i qëndrueshëm. E gjithë kjo ka sjellë vlefshmëri dhe besueshmëri tek nxënësit dhe mësimdhënësit me një përqindje të pozitive.

Nga anketimi me mësimdhënësit në tabelën 6 dhe grafiku 5 me nxënës, rezultoni se nuk ka diferencë pikëpamja statistikore, përqindja më e madhe deklarojnë se metodat dhe teknikat e përdorura nga mësimdhënësit gjatë procesit të vlerësimit, kanë arritur të sigurojnë pritshmëritë e të dy palëve. Nga rezultatet e grafikut 6 dhe analiza e të dhënave, rezultoni se mësimdhënësit kanë përdorur më shumë: Vëzhgimi dhe vlerësimi me gojë; vlerësimi i angazhimit dhe i pjesëmarrjes gjatë mësimin në distancë dhe paraqitja e detyrave dhe e punimeve gjatë mësimin në distancë, për të cilat kanë menduar se kanë qenë më efektive, ndërsa metodat tjera kanë një përqindje më të ulët dhe janë praktikuar me pak.

6. REKOMANDIMET

Analiza dhe përpunimi i gjetjeve të këtij punimi shkencor tenton të japi edhe disa rekomandime për organizmat që merren me politikën e arsimit në Kosovë dhe më gjërë. Duke ditur faktin se vlerësimi është proces kompleks, dhe sfida për shumë sisteme të arsimit në botë në kushte normale e sidomos në një gjendje të jashtë zakonshme siç është pandemia COVID-19.

Këto rekomandime në të ardhmen synojnë të ndihmojnë mësimdhënësit për të kuptuar drejtë ndryshimet në vlerësimin e nxënësve dhe për të zhvilluar shkathtësitë në zbatimin e vlerësimit në distancë, si një formë e re dhe sfiduese për kohën, por e nevojshme për realizimin e kërkesave bazuar në kurrikul.

Edhe përkundër sfidave më të cilat janë ballafaquar mësimdhënësit dhe nxënësit, nga pasqyrimi i gjetjeve, analiza dhe përpunimi i të dhënave, mund të rekomandojmë se metodat e vlerësimit të njohurive të nxënësve në perspektivë,

jo vetëm që janë inovative, por mund të jenë efektive dhe shumë të dobishme. Në këtë konkluzion kemi arritur si rezultat i këtij punimi shkencor nga anketimi dhe përgjigjet e marra nga mësuesit dhe nxënësit. Andaj, rekomandojmë që institucionet më të larta arsimore në ardhmen të formojnë grupe ekspertesh për organizimin e punës dhe trajnimin e mësuesve për metodat e vlerësimit të njohurive të nxënësve në distancë.

Mënyra e vlerësimit të nxënësve në distancë nxjerr në pah nevojën për ndryshimin e vlerësimit në të ardhmen. Nga analiza e gjetjeve të hulumtimit mund të konkludohet se, akoma në shkollat tona përdoret metoda tradicionale të vlerësimit të nxënësve e që nuk janë atraktive dhe inkurajuese për nxënësit. Edhe pse në kushte të jashtëzakonshme, vlerësimi i nxënësve në distancë, nga gjetjet e hulumtimit tek pjesa dërmuese e nxënësve kjo formë e vlerësimit ka qenë tërheqëse, kreative, nxitëse dhe ka krijuar mundësi që të gjithë nxënësit të vlerësohen në mënyrë të përshtatshme.

LITERATURA

- MASHT, (2020). Udhëzues për vlerësimin e nxënësve gjatë mësimit në distancë, Prishtinë
- MASR, (2020). Udhëzues për vlerësimin e nxënësve gjatë mësimit në distancë dhe për mbylljen e vitit shkollor 2019-2020, Tiranë
- MASHT, (2016). Udhëzuesin për vlerësimin e nxënësve sipas kurrikullës së bazuar në kompetenca
- MASHT-it & GIZ IS (2013). Moduli 5 për Aftësimin e Mësuesve në Shërbim: Vlerësimi në funksion të zhvillimit të kompetencave të nxënësve..
- Mmiller, A. (2020). <https://www.edutopia.org/article/summative-assessment-distance-learning>
- Vlerësimi i nxënësve, (2019). Projekti “Zhvillimi Profesional i Mësuesve” (European Union Kosovo), Prishtinë
- Osmani, F. (2010). Sistemi I vlerësimit në funksion të procesit mësimor, Tetovë
- Grup autorësh (2005), Programi nacional për zhvillimin e arsimit në Republikën e Maqedonisë 2005 – 2015. <https://www.ispringsolutions.com/blog/8-ways-to-assess-online-student-learning>
<https://blogs.worldbank.org/education/are-students-still-learning-during-covid-19-formative-assessment-can-provide-answer>